



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 64 Akti**

**Nr. 91 Vendimi**

**Tiranë, më 20.12.2018**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Xhensila Pine	Anëtare
Pamela Qirko	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Maria Tuma, më datë 18 dhjetor 2018, ora 12:00, në Pallatin e Kongreseve, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Alfred Progonati**, prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE :** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (referuar më poshtë “Kushtetuta”);  
**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (referuar më poshtë ligji nr. 84/2016);

**Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, atë pasuror, të figurës dhe vlerësimin profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, ushtron detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur, më datë 15.01.2018, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
3. Në referim të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar menjëherë, pasi janë caktuar me short trupat gjyquese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe është shortuar shpërndarja e çështjes konkrete.
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 24.01.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuesi i trupit gjykues, znj. Genta Tafa (Bungo). Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.
5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Prokuroria e Përgjithshme.

6. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ, si më poshtë vijon:

7. **Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI)** ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.11.2017, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016; në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

8. **Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me atë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontaktet të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016; në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Alfred Progonati.*

9. **Prokuroria e Përgjithshme** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. \*\*\* prot., datë 17.04.2018.

10. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

11. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë **05.12.2018**, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

12. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga

ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes, më datë 06.12.2018 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së shpjegimeve të tij më datë 13.12.2018.

13. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjyqës, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

14. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, më datë 13.12.2018.

15. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 18.12.2018, ora 12:00, në sallën e seancave dëgjimore, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Maria Tuma.

16. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

17. Z. Alfred Progonati, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë kërkuar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

18. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

19. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) Provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja;
- b) Aktin përfundimtar të kontrollit të ILDKPKI-së;
- c) Provat shkresore të administruara nga Komisioni në dosje, të marra nga institucionet publike dhe private;
- ç) Pyetjet, pyetësorët dhe përgjigjet e subjektit lidhur me konstatimet e bëra nga Komisioni;
- d) Sugjerime të vëzhguesit ndërkombëtar, për rrethana konkrete në procesin e rivlerësimit;
- dh) Çdo dokument që përbën mjet prove, sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016.

20. Në Deklaratën e Pasurisë “Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 24.01.2017, **subjekti ka deklaruar këto pasuri** (të paluajtshme dhe të luajtshme) në emër të tij:

**21. Apartament banimi**, me sip. 126 m<sup>2</sup>, ndodhur në, Lagjja: “\*\*\*\*”, Rr. “\*\*\*\*”, ndërtesa \*\*\*, hyrja \*\*\*, apartamenti \*\*\*, Tiranë, prenotuar në vitin 2005, te firma e ndërtimit “\*\*\*\*” sh.p.k., **përfunduar në vitin 2006**, dhe lidhur kontrata noteriale përfundimtare e blerjes, nr. \*\*\*, datë 16.02.2011, certifikata e pronësisë, nr. \*\*\*, datë 25.02.2011.

Vlera është **70.000 euro** (shtatëdhjetë mijë). Pjesa takuese: 100 %.

### **21.1 Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës “Vetting”:**

- ✓ Të ardhurat nga shitja e banesës, në shumën **1.500.000 lekë** dhe një garazhi në shumën **500.000 lekë**, në qytetin e Tepelenës, përfitur nga ligji i privatizimit të banesave. Kontratat noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.04.1998, dhe nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.12.1998.
- ✓ **Shuma 31.000 euro**, kredi nga “Tirana Bank”, me kontratën nr. \*\*\*, datë 26.07.2006, noteruar me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.07.2006.
- ✓ Kursimet e mbledhur nga paga juaj dhe e bashkëshortes, vit pas viti, deri në fund të vitit 2006.

21.2 Në lidhje me këtë apartament, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Certifikatë pronësie, nr. \*\*\*, datë 25.02.2011, për apartamentin, me sip. 126 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\*, kartelë pasurie, në vlerën 8.500.000 lekë, në emër të subjektit.
- Kontratë shitje pasurie e paluajtshme, për apartamentin me sip. 126 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, datë 16.02.2011, në shumën 8.500.000 lekë = 70.000 euro, me palë shitëse: S. J dhe Sh. J, identifikuar si “*investitorë*” të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për kalimin e pronësisë së një apartamenti me sip.126 m<sup>2</sup>, ndodhur në : Rr. “\*\*\*\*”, sh. \*\*\*, k. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\*, kundrejt çmimit 8.500.000 lekë = 70.000 euro, shumë e cila është likuiduar tërësisht përpara lidhjes së kësaj kontrate.
- Kontratë shitje, nr. \*\*\*, datë 24.04.1998, në vlerën 1.500.000 lekë. Autorizim datë 28.05.1996, mandatpagesë të shumës 4.204 lekë, për privatizim banese.
- Kontratë për privatizim banese, datë 09.05.1995, nga Enti i Kombëtar i Banesave. Vërtetim nr. \*\*\*, datë 11.05.1995.

- Kontratë shitje, nr. \*\*\*, datë 21.12.1998, nga zyra e hipotekës Tepelenë, në vlerën **400.000 lekë**, (ka deklaruar 500.000 lekë).
- Kontratë nr. \*\*\*, datë 26.07.2006, për hua afatgjatë me “Tirana Bank”, nr. \*\*\*, datë 27.07.2006, për shumën 30.000 euro kredi dhe 1.000 euro garanci për kartën “Visa Card” - huamarrës Alfred Progonati dhe M. P.
- Shtojcë kontratë kredie me “Tirana Bank”, nr. \*\*\*, datë 07.11.2007 (ndryshim i interesit të kredisë).
- Kontratë hipotekimi në “Tirana Bank”, nr. \*\*\*, datë 16.03.2011, të pasurisë së blerë me nr. pasurie: \*\*\*, vol. 41, fq. \*\*\*, ZK \*\*\*.
- Shtojcë kontratë kredie me “Tirana Bank”, nr. \*\*\*, datë 16.3.2011(ndryshim i interesit të kredisë).
- Deklaratë noteriale, nr. \*\*\*, datë 28.03.2011, e përfaqësuesve të “Tirana Bank”, për lirimin e pronës nga barra hipotekore, përpara noteres E. K.
- Kontratë kredie bankare, nr. \*\*\*, datë 09.03.2016, “Kredi për çdo dëshirë”, me “Tirana Bank”, nr. \*\*\*, datë 29.03.2016, për shumën 1.800.000 lekë.
- Kontratë hipotekimi, pranë “Tirana Bank”, nr. \*\*\*, datë 29.03.2016, të pasurisë së blerë me nr. pasurie: \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\*.

### 21.3 Hetimi i kryer nga Komisioni:

- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.01.2018, drejtuar Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2018, drejtuar ZVRPP-së Tiranë.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.01.2018, drejtuar “Ujësjetës Kanalizime Tiranë”.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.01.2018 drejtuar, “Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.01.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.01.2018, drejtuar zyrës së regjistrimit noterial të Ministrisë së Drejtësisë.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.01.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.10. 2018, drejtuar DRSHTRR-së Tiranë.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.01.2018, drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2018, drejtuar “Tirana Bank”.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2018, drejtuar noteres F. Sh.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2018, drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2018, drejtuar Autoriteti të Mbikëqyrjes Financiare.

### Arsyetimi ligjor:

21.4 Me kontratën e sipërmarrjes, nënshkruar më datë 30.05.2005, me palë porositëse subjektin e rivlerësimit dhe palë sipërmarrëse shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., është porositur ndërtimi i një apartamenti me sipërfaqe totale 134,4 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe banimi 125,3 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 67.000 euro. Në këtë kontratë palët deklarojnë se është likuiduar shuma 40.000 euro.

21.5 Me kontratën e shitblerjes, nr. \*\*\*, datë 16.02.2011, midis shitësve S. J dhe Sh. J dhe blerësit Alfred Progonati është realizuar kalimi përfundimtar i apartamentit me sipërfaqe 126 m<sup>2</sup>. Pronësia e apartamentit në emër të shitësve rezulton sipas certifikatës së pronësisë, nr. \*\*\*, datë 15.02.2011 (bashkëlidhur shkresës së ZVRPP-së Tiranë). Çmimi i blerjes në këtë kontratë është përcaktuar 8.500.000 lekë = 70.000 euro për sipërfaqen 126 m<sup>2</sup>.

21.6 Nga dokumentacioni i ZVRPP-së Tiranë, mbi godinën ku ndodhet apartamenti i porositur nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se: në bazë të kontratave me natyrë zhvillimore mes pronarëve të truallit dhe investitorëve, në përfundim të drejtën e ndërtimit e ka shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me investimin e shtetasve S. J dhe Sh. J, të cilët janë edhe persona në marrëdhënie tregtare brenda subjektit tregtar “\*\*\*\*” sh.p.k. Në përfundim të objektit, përpara regjistrimit të tij në ZVRPP-në Tiranë, rezulton se janë likuiduar detyrimet tatimore përkatëse. Pas lejes së shfrytëzimit, investitorët S. J dhe Sh. J rezultojnë si bashkëpronarë të këtij ndërtimi, me regjistrim hipotekor fillestar, nr. \*\*\*, datë 20.02.2009. Që nga ky moment, i ka lindur e drejta e disponimit të ambienteve të ndërtuara, sikurse kanë vepruar në rastin e kontratës, nr. \*\*\*, datë 16.02.2011, me subjektin e rivlerësimit.

21.7 Si rezultat i kontratës së mësipërme, ZVRPP-ja Tiranë ka regjistruar apartamentin në fjalë në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

21.8 Rezultoi se, fillimisht çmimi i këtij apartamenti ishte 67.000 euro, si prenotim, prej të cilave subjekti i rivlerësimit deklaroi në vitin 2005 dhe në kontratën e sipërmarrjes se kishte likuiduar shumën prej 40.000 eurosh, me burim: të ardhurat nga viti 2004 plus shumën 1.000.000 lekë (kursime) nga të ardhurat e siguruar nga paga në vitin 2005 (ndërsa, pjesa tjetër do të likuideohej pas përfundimit të apartamentit).

21.9. Gjendja e kursimeve të subjektit të rivlerësimit në vitin 2004 rezultoi në shumën:

- Shuma prej 3.000.000 lekësh, të kursyera nga viti 2003, me burim:
  - shitja e banesës (1.500.000 lekë) dhe e garazhit (400.000 lekë);
  - kursime nga paga (1.100.000 lekë).
- Shuma prej 660.000 lekësh, me burim:
  - shitja e autoveturës, tip “Volkswagen Polo” (60.000 lekë);
  - kursime pagat (600.000 lekë).

21.10 Total kursime të deklaruara nga subjekti për periudhën 2003 - 2005: shuma 4.660.000 lekë, me të cilat deklarohet se ka likuiduar pjesën e parë të çmimit të apartamentit prej 67.000 eurosh.

21.11 Nga analiza financiare shumat e paguara deri në fund të vitit 2005 nuk e arrijnë plotësisht shumën në euro. Por, nga ekstraktet bankare të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., rezulton që pagesat e derdhura në bankë për llogari të subjektit të rivlerësimit, janë në shumën 41.000 euro. Mbi këtë konstatim subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se, pagesat deri në përfitimin e kredisë nga “Tirana Bank”, i ka kryer në monedhën “Lekë”, në shumën prej 4.700.000 lekësh. Këtë fakt e konfirmojnë edhe shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k edhe shitësit S. J dhe Sh. J (në kontratën përfundimtare).

21.12 Në kontratën përfundimtare të shitblerjes, në vitin 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka paguar tek shitësit (S. J dhe Sh. J) shumën 8.500.000 lekë = 70.000 euro. Burimi i të ardhurave për diferencën e pagesës rezulton kredia që subjekti ka përfituar nga “Tirana Bank”, në vitin 2006, në shumën prej 29.000 eurosh në bazë të kontratës së kredisë me këtë bankë, duke arritur pagesat në total në shumën 70.000 euro. Për shtesën prej 3.000 eurosh, të rezultuar nga prenotimi deri në shitjen përfundimtare, subjekti ka deklaruar se kjo shumë lidhet me punime shtesë në këtë vlerë, sipas preventivit të sipërmarrësit, me vlerë totale 3.039 euro.

21.13 Në këtë apartament subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij, është vendosur në fund të muajit dhjetor 2006, bazuar në librezat e energjisë elektrike, ujësjellës kanalizime dhe telefoni fikse që i përkasin gjysmës së parë të vitit 2007.

21.14 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar rregullisht marrëdhënien juridike në lidhje me asetin në deklarimin e pasurive dhe interesave të vitit 2005 referuar porositjes, në deklarimet e viteve 2006 - 2017, referuar qëllimit të marrëdhënies së kredisë “Tirana Bank”: si dhe si marrëdhënie pasurore të realizuar në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

21.15 Nga analiza financiare, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme nga paga e tij dhe e bashkëshortes, për të krijuar gjendjen e kursimeve në monedhën lekë të deklaruara në vitet 2003, 2004 dhe 2005, me të cilat likuidon pjesërisht apartamentin në fjalë në shumën prej 4.660.000 lekësh. Gjithashtu, konfirmohet nga “Tirana Bank”, marrëdhënia e kredisë në vitin 2006, për financimin e blerjes së këtij apartamenti në shumën 29.000 euro (sipas kontratës së kredisë së datës 01.07.2006). Mbi këto pagesa, si dhe mbi pagesën e shumës 3.000 euro kanë dhënë konfirmim me shkrim edhe subjekti tregtar “\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe dy shitësit S. J dhe Sh. J.

Në përfundim të një analize të plotë të provave, fakteve dhe të gjithë dokumentacionit përkatës, Komisioni konstaton se:

- ✓ Përputhen deklarimet e subjektit me rezultatet e hetimit administrativ.
- ✓ Deklarimi është i saktë.



**22. Autoveturë, tip “Toyota Rav. 4”, me naftë, nr. \*\*\* shasje, me targa \*\*\*, blerë nga personi fizik E. D, me numër identifikimi \*\*\*, me faturë tatimore nr. \*\*\*, datë 12.12.2014, në vlerën 3.360 euro - në emër të subjektit të rivlerësimit.**

**Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës “Vetting” : kursimet nga të ardhurat nga paga. Pjesa takuese: 100 %.**

22.1 Për këtë pasuri, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Kontratë shitblerje, datë 12.12.2014, për autoveturën, tip “Toyota Rav 4” naftë, vit prodhimi 2002, nr. \*\*\* shasje, ngjyrë gri, çmimi 3.360 euro, mes shitësit, E. D, me \*\*\*.
- Faturë tatimore shitje, nr. \*\*\*, datë 12.12.2014, seria nr. \*\*\*, vlefata me TVSH 3.360 euro.
- Certifikatë pronësie italiane, për autoveturën, tip “Toyota Rav 4”, targa \*\*\*, nr. \*\*\* shasje, me vërtetim përkthimi në shqip, nr. \*\*\* rep., datë 13.12.2014.
- Leje qarkullimi italiane (përkthyer, librezë mjeti), për automjetin, tip “Toyota Rav 4”, targa \*\*\*, nr. \*\*\* shasje, me targë \*\*\*, me vërtetim përkthimi nr. \*\*\* rep., datë 13.12.2014.
- Faturë shitje italiane, nr. \*\*\*, datë 14.11.2014, nr. \*\*\* dokumenti, lëshuar nga shoqëria tregtare “\*\*\*\*” s.p.a. për blerësin E. D, në vlerën 2.600 euro (me TVSH) për mjetin me targë \*\*\*, me nr. \*\*\* shasje, me vërtetim përkthimi nr. \*\*\* rep., datë 13.12.2014.
- Deklaratë doganore, R. \*\*\*, datë 07.12.2014, në Doganën e Durrësit në emër të deklaruesit “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe për importuesin E. D për automjetin, tip “Toyota Rav 4”, vit prodhimi 2002, detyrimi shuma 77.194 lekë.
- Urdhër çlirimi i doganës së Durrësit, datë 07.12.2014.

22.3 Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.01.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.10. 2018, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë.
- Shkresë nr. \*\*\* rep., datë 15.10.2018, drejtuar Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

**Arsyetimi ligjor:**

22.4 Subjekti i rivlerësimit ka blerë në vitin 2014, automjetin tip “Toyota Rav 4”, për shumën 3.360 euro, në bazë të kontratës së shitjes, datë 12.12.2014, dhe faturës tatimore nr. \*\*\*, datë 12.12.2014. Nga hetimi administrativ bazuar në shkresën e DPSHTRR-së rezulton se automjeti është blerë me detyrime doganore të likuiduara dhe më pas, subjekti i rivlerësimit e ka regjistruar pranë DRSHTRR-së Tiranë, pajisur me targë \*\*\*.

22.5 Blerjen e automjetit subjekti e ka deklaruar në deklaratën e pasurisë dhe interesave të vitit 2014. Në lidhje me gjendjen e tij financiare në këtë vit, janë llogaritur kursimet e deklaruara prej tij deri një vit më parë (periudha 2010 - 2013) si dhe të ardhurat deri në momentin e likuidimit të faturës së automjetit, duke rezultuar me një balancë me vlerë negative - 92.486 lekë. Në analizën financiare janë marrë në konsideratë të gjitha të ardhurat nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes së tij, si dhe kursimet e deklaruara pas zbritjes së kostove të jetesës dhe detyrimeve për kreditë bankare të likuiduara deri në ato momente. Komisioni, bazuar në analizën financiare ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë likuiditetesh të shtrira në vite për mbulimin e shpenzimeve të kryera, të deklaruara nga ai për blerjen e automjetit. Për këtë shkak, në rezultatet e hetimit subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime dhe prova për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

22.6 Mbi diferencën e konstatuar, subjekti i rivlerësimit argumenton se mund të jetë ndonjë gabim në përlllogaritje, për arsye se gjatë vitit 2014, të ardhurat nga paga dhe shpërblimet arrijnë në vlerën 2.166.224 lekë dhe kostot e shpenzimeve për këtë vit, arrijnë në vlerën 1.679.466 lekë. D.m.th., rezulton një diferencë neto prej 478.158 lekësh që e mbulon blerjen e automjetit në shumën 3.360 euro. Nga shpjegimet e subjektit të rivlerësimit rezulton se pagesa i është bërë në lekë dhe jo në euro.

22.7 Për likuidimin e faturës së shitjes së automjetit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ia ka dorëzuar shitësit *cash* (në dorë), i cili më pas i ka dhënë faturën dhe dorëzuar automjetin. Ky fakt konfirmohet edhe nga subjekti tregtar person fizik E. D, me deklarin e tij si dhe me fletën e librit të shitjes për muajin dhjetor 2014.

22.8 Në lidhje me deklarin e subjektit të rivlerësimit për kursimet e krijuara deri në fund të vitit 2014, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të kursyer shumën të cilën ka shpenzuar për blerjen e automjetit, por ky kursim nuk është pasqyruar në deklaratën periodike përkatëse.

22.9 Trupi gjykues çmon se mungesa e likuiditeteve (- 92.486 lekë) përgjatë viteve, pas analizës financiare të përditësuar, nuk ka një peshë specifike në vlerësimin financiar që mund të çojë në ngritjen e dyshimeve të mëtejshme në këtë proces. Ky përfundim arrihet pasi në vlerësim duhet të marrë parasysh marzhi i pasaktësisë që përmban gjithmonë analiza financiare, krahasuar me kostot reale të jetesës. Për sa arsyetohet më sipër, trupi gjykues çmon se mungesa e këtij likuiditeti nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

✓ Nga hetimi i kryer, ka rezultuar se nuk ka dyshime lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie. Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar në dosje.

**23.1 Gjendje *cash*, në shumën 400.000 lekë.**

**23.1.1 Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës “Vetting”:** kursimet nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes. Zotëron: 100%.

**dhe**

**23.2 Gjendje cash, në shumën 500.000 lekë të mbetura nga kreditë.**

**23.2.1. Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës “Vetting”:** të ngelura nga kredia konsumatore, marrë pranë “Tirana Bank”, me kontratë nr. \*\*\*, datë 09.03.2016, në shumën 1.800.000 lekë, noterizuar me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.03.2016. Zotëron: 100%.

**dhe**

**23.3. Transfertë bankare në shumën 1.500 euro,** nga “Tirana Bank”, më datë 06.09.2016, në llogarinë bankare të vajzës së subjektit, Xh. P, në Gjermani, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve.

**23.3.1 Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës “Vetting”:** Nuk deklarohet.

- Vërtetim me nr. \*\*\* prot., datë 10.10.2016, nga Prokuroria e Përgjithshme për shumën 24.637.571 lekë.
- Vërtetim me nr. \*\*\* prot., datë 09.01.2017, nga Prokuroria e Përgjithshme, në vlerën 396.858 lekë.
- Vërtetim me nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2016, nga KLD-ja, në vlerën totale 2.846.035 lekë.
- Vërtetim me nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2016, nga Prokuroria e Shkallës së Parë Përmet, për periudhën 1 janar 1994 - shtator 1997, në vlerën 571.374 lekë.
- Vërtetim lëshuar nga Prokuroria e Shkallës së Parë Gjirokastrë, datë 13.10.2016, për periudhën 1 mars 1997 - mars 1998, në vlerën 302.177 lekë.
- Vërtetim nga Prokuroria e Shkallës së Parë Gjirokastrë, datë 13.10.2016, konfirmon se Prokuroria Tepelenë, deri në mars 1997, nuk disponon dokumente për listë pagesë për subjektin.
- Vërtetim me nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2016, që konfirmon se për periudhën maj 1988 - gusht 1992, nuk disponon regjistra page pranë arkivit të institucionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.
- Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2016, nga Prokuroria e Shkallës së Parë Përmet, që konfirmon se për periudhën tetor 1986 - 30 prill 1988, nuk disponon regjistra page pranë arkivit të institucionit. Bashkëngjitur regjistër themeltar i punonjësve, pa vlerë.
- Vërtetim lëshuar nga Qendra e Botimeve Zyrtare, nr. \*\*\* prot., datë 19.01.2017, në vlerën totale 6.875.669 lekë, dhe tabela përmbledhëse nga data 08.05.2001 - 31.10.2016.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme të pagës lëshuar nga Bashkia Tepelenë, për periudhën shkurt 1994 - gusht 1998, në shumën 306.529 lekë. Vërtetim me nr. \*\*\* prot., datë 24.10.2016, lëshuar nga Drejtoria Arsimore Tepelenë.

- Vërtetim i datës 24.10.2016, lëshuar nga Bashkia Memaliaj, për periudhën nga viti 1991 deri në vitin 1994, në shumën 45.212 lekë.
- Kontratë për kredi për blerje banese, datë 26.07.2006, nga “Tirana Bank”, në shumën 31.000 euro.
- Kontratë për kredi konsumatorë, datë 02.07.2007, me “Raiffeissen Bank”, në shumën 700.000 lekë.
- Kredi për nevoja personale, datë 09.03.2016, nga “Tirana Bank” (mobilim shtëpie dhe shlyerje kredie konsumatore të mëparshme pranë “Raiffeissen Bank”), në shumën 1.800.000 lekë.
- Konfirmim pagese nga “Tirana Bank”, në shumën 1.500 euro, në favor të Xh. P, nga “Tirana Bank” drejt “Deustch Bank Ag”, datë 06.09.2016.

#### 23.4. Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.01.2018, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, mbi të ardhurat bruto dhe neto të anëtarëve të familjes së z. Alfred Progonati.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2018, drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.01.2018, drejtuar të gjitha
- bankave të nivelit të dytë.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2018, drejtuar “Tirana Bank”.

#### **Arsyetimi ligjor:**

24. Në çdo vit (me përjashtim të vitit 2009) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtesa të gjendjes *cash* që kanë rezultuar në fund të vitit përkatës të deklarimit.

25. Një shpenzim i rëndësishëm i tij, ka qenë mbështetja financiare e vajzës së subjektit, znj. Xh. P, për shkollimin e saj në Gjermani.

26. Në lidhje me shpenzimet e shkollimit të saj, në universitet në Gjermani, gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar të gjitha shpenzimet që ka përballuar ai vetë, duke shpjeguar rrethanat e qëndrimit të së bijës në atë vend si dhe kostot përkatëse për shkollim, akomodim dhe taksa, si dhe mundësinë e përdorimit të shumës së ngurtësuar që më parë nga studenti në shumën 8.640 euro si kosto jetese.

27. Për sa më sipër subjekti e ka mbështetur me dokumentacionin bankar transaksionin e shumës 8.000 euro (depozitimi cash në datë 12.02.2016 në Pro Credit Bank), për të cilat ka deklaruar se ka pasur si burim kursimet e akumuluar në vite nga paga e tij dhe e bashkëshortes. Kjo shumë rezulton se është derdhur nga ana e tij në llogarinë e znj. Xh. P, pranë "Pro Credit Bank", më datë 12.02.2016. Më pas, në datë 20.05.2016, nga kjo shumë, vajza e tij ka transferuar në llogarinë bankare të saj në Bielefeld Gjermani shumën 7.937 euro.

28. Më datë 06.09.2016, subjekti ka derdhur në llogarinë tij në "Tirana Bank", shumën 1.550 euro dhe po në datë 06.09.2016, kjo shumë rezulton se është transferuar në llogarinë e znj. Xh. P në Gjermani.

29. Kontributi financiar i subjektit për shkollimin e së bijës në Gjermani, provohet me dokumentacion bankar të "ProCredit Bank" dhe "Tirana Bank". Për vërtetësinë e dokumentacionit të shkollimit, subjekti ka sjellë dokumentacion të "Universitetit Bochum", të "Universitetit Bielefeld", nga Shoqëria Publike e Banesave dhe nga sigurimi shëndetësor.

30. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime mbi të drejtën e së bijës për të punuar deri në 120 ditë pune në Gjermani. Në vitin 2017 ajo ka realizuar të ardhura neto në shumën 1.530 euro, ndërsa në vitin 2018 ka realizuar të ardhura neto në shumën 3.750 euro. Ky fakt, mbështetet në ekstrakte/pasqyra ku evidentohen të ardhura neto në emër të znj. Xh. P.

31. Dokumentacioni justifikues i subjektit të rivlerësimit, pas shqyrtimit, rezulton të jetë lëshuar nga autoritetet kompetente në mënyrë të rregullt dhe si të tilla janë bërë pjesë e dosjes.

32. Nga analiza financiare e të ardhurave (nga paga, shpërblimet dhe të hyrat nga kreditë) dhe shpenzimeve deri në deklaratën "Vetting", subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me një balancë me vlerë pozitive (+ 1.322.421 lekë).

33. Në analizën financiare janë marrë në konsideratë të gjitha të ardhurat nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes së tij, të hyrat nga kreditë si dhe kursimet e deklaruara pas zbritjes së kostove të jetesës dhe detyrimeve për kreditë bankare të likuiduara deri në ato momente.

✓ Subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar gjendjet e kursimeve cash në shumat: 400.000 lekë, 500.000 lekë, si dhe për transfertën në shumën 1.500 euro.

#### **34. Konkluzion përfundimtar mbi vlerësimin e pasurisë**

34.1 Në lidhje me problemet e deklarimeve të evidentuara më sipër, konkludohet se subjekti nuk ka pasur për qëllim fshehjen e të ardhurave apo pasurisë së tij apo personave të lidhur me të. Është i qartë fakti se diferencat e vogla të konstatuara janë rezultat i gabimeve në konvertim, pasi subjekti nuk ka bërë likuidime me monedhën euro. Kjo rrethanë, nuk lidhet me punën apo të ardhurat e subjektit. Diferenca e shumës prej 92.486 lekësh e shtrirë ndër vite, nuk është e tillë që të krijojë dyshime për mënyrën e fitimit të të ardhurave.

34.2 Nga analiza financiare ndër vite rezulton se subjekti ka pasur mjete monetare të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e kryera.

34.3 Pasaktësitë e konstatuara nuk krijojnë dyshime të arsyeshme për veprime që cenojnë figurën e prokurorit.

34.4 Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, këto pasaktësi nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni, çmon se në këtë rast pasaktësitë e konstatuara nuk çmohen se cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut tek drejtësia.

34.5 Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, si dhe nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.

34.6 Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

## **B. VLERËSIMI I FIGURËS**

35. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Nga hetimi administrativ nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Për subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Progonati, konstatohet se është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si prokuror.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**36. Prokuroria e Përgjithshme (PP)** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit,

sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. \*\*\* prot., datë 17.04.2018.

36.1 Raporti për analizën e aftësive profesionale kryer nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, është bazuar në:

- 1) Formularit të vetëdeklarimit si dhe të 3 (tre) dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 2) Pesë dosje penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) Të dhënat nga burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, struktura të tjera të Prokurorisë së Përgjithshme dhe ato të administruara nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore në Republikën e Shqipërisë.

36.2 Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, i bazuar në gjetjet e këtij raporti, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konstatohet si më poshtë:

## **37. Lidhur me aftësitë profesionale**

### 37.1 Njohuritë ligjore

37.1.1 Subjekti i rivlerësimit, prokurori Alfred Progonati, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në disa raste, e analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e lidhur përmbajtjen e saj me akte të tjera ligjore dhe nënligjore apo me praktikën gjyqësore, kryesisht atë unifikuese të Gjykatës së Lartë.

37.1.2 Në rastin e çështjeve me natyrë procedurale, përdor metodat e interpretimit për të nxjerrë thelbin e institutit procedural që është në diskutim. Ndërsa në rastin kur problematika lidhet me zbatimin e ligjit material, i kushton rëndësi çdo elementi të veprës penale për të konkluduar në kualifikimin e faktit penal sipas normës penale. Identifikon rastet kur norma ligjore plotësohet nga akte nënligjore. I kushton rëndësi analizës së provave të administruara.

37.1.3 Ka respektuar parashikimet ligjore dhe ato nënligjore. Aktet janë përgatitur prej tij, në respektim të dispozitave procedurale penale por edhe të urdhrin nr. 174, datë 05.09.2003, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore”. Aktet e përpiluara prej tij, janë ruajtur në sekretarinë e prokurorisë, në respektim të plotë të urdhrin.

37.1.4 Mbështetur në nenin 418, 432 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale si dhe në udhëzimin nr. 1, datë 14.11.2008, “*Për ushtrimin me evidencë të së drejtës së ankimit*”, prokurori Alfred Progonati, ka respektuar procedurat për ushtrimin e rekursit, mbështetjen apo jo të ankimit të prokurorit.

37.1.5 Në vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurorit Alfred Progonati, për vitet 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se:

37.1.6 Për vitin 2014 - subjekti i rivlerësimi, z. Alfred Progonati, është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm.

37.1.7 Për vitin 2015 - subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm.

37.1.8 Për vitin 2016 – subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm.

## 38. Arsyetimi ligjor

38.1. Subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, ka aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara prej tij, janë të qarta dhe të kuptueshme. Ai respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor përgjithësisht të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit të përgatitur prej tij. Aktet e përpiluara prej tij, konceptohen me tre pjesë. Përgjithësisht, përmbajtja e aktit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje çështjeve që parashtrihen për zgjidhje. Në tekstet e akteve ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur prokurori. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore dhe provave.

38.1.2 Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

38.1.3 Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Alfred Progonati, për vitet 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se:

38.1.3 Për vitin 2014 - subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm.



38.1.4 Për vitin 2015 - subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm.

38.1.5 Për vitin 2016 - subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm.

### **39. Lidhur me aftësinë organizative**

39.1 Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

39.1.1 Subjekti rivlerësimit, z. Alfred Progonati, për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016, ka ushtruar funksionin e prokurorit, si prokuror në Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore. Për këtë shkak aktet/dokumentet e tij, konstatohen se kanë si objekt të tyre, kontrollin e ushtruar mbi veprimtarinë e punës së prokurorëve të tjerë.

39.1.2 Subjekti rivlerësimit, z. Alfred Progonati, ka trajtuar gjithsej 181 (*njëqind e tetëdhjetë e një*) çështje/ praktika.

39.1.3 Konstatohet se prokurori Alfred Progonati, subjekt rivlerësimi, për periudhën e rivlerësimit, nuk ka ushtruar ndjekje penale në hetim për shkak të funksionit që ka kryer. Ai ka ushtruar detyrën si prokuror më i lartë, sipas hierarkisë në prokurori, duke evidentuar shkeljet ligjore dhe të akteve nënligjore të kryera nga prokurorët, ka përgatitur vendimet për shfuqizimin e vendimeve, përfaqësimin e Prokurorisë së Përgjithshme në gjykime administrative e të tjera.

39.1.4 Lidhur me efektivitetin në aspektet sasiore dhe kohore, prokurori Alfred Progonati, subjekt rivlerësimi, për shkak të detyrës që ka kryer, analiza e të dhënave të tij bëhet në referencë të ligjit procedural penal, Kushtetutës dhe Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

39.1.5 Ai ka përballuar ngarkesën e punës, me efikasitet.

39.1.6 Nga analiza e çështjeve të përzgjedhura në short, rezultoi se qëndrimi i tij është shprehur brenda afateve, sipas kërkesave të akteve nënligjore dhe ligjore.

39.1.7 Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurori Alfred Progonati, është eficient dhe efektiv. Në efektivitetin dhe evidencën e veprimtarisë së tij nuk ka ndikuar ngarkesa sasiore, e cila ka qenë e lartë. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

39.1.8 Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Alfred Progonati, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se:

39.1.9 Për vitin 2014 - subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, është vlerësuar “Shumë Mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij.

39.1.11 Për vitin 2015 - subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, është vlerësuar “Shumë Mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij.

39.1.12 Për vitin 2016 - subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, është vlerësuar “Shumë Mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij.

### 39.2 Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

39.2.1 Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Alfred Progonati, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se:

39.2.2 Për vitin 2014 - subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, është vlerësuar “ Shumë Mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij.

39.2.3 Për vitin 2015 - subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati ,është vlerësuar “ Shumë Mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij.

39.2.4 Për vitin 2016 - subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, është vlerësuar “ Shumë Mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij.

### 39.3 Aftësia për të administruar dosjet

39.3.1Subjekti i rivlerësimit, prokurori Alfred Progonati, nuk ka pasur në administrim përfundimtar dosje. Administrimi i akteve që janë përpiluar prej tij, rezulton të jetë bërë në mënyrë të rregullt duke i bashkëlidhur aktet shtesë që kanë iniciuar punën e tij.

## **40. Lidhur me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale**

### 40.1 Etika në punë

40.1.1 Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Alfred Progonati, konstatohet se ka ushtruar detyrën prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme.

4.1.2 Për periudhën e rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit, prokurori Alfred Progonati, ka ushtruar funksionin e prokurorit në Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, në fushën e së drejtës penale dhe procedurale penale, inspektim dhe kontroll i veprimtarisë së prokurorëve të prokurorive pranë gjykatave të shkallëve të para dhe apeleve, përfshirë shfuqizime të vendimeve të pushimit dhe mosfillimit të procedimeve penale. Gjithashtu ai ka ndjekur dhe përgatitur praktikat në fushën e zbatimit të ligjit nr. 10173 datë 22.10.2009, “*Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë*”.

40.1.3 Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet/praktikat e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve, është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

40.1.4 Nga verifikimi në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, rezultoi se për periudhën e rivlerësimit tetor 2013 - tetor 2016, për subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Progonati, nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

40.1.5 Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Alfred Progonati, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se:

40.1.6 Për vitin 2014 – subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, është vlerësuar “Shumë Mirë” për aftësitë personale e qëndrimit shoqëror.

40.1.7 Për vitin 2015 - subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, është vlerësuar “Shumë Mirë” për aftësitë personale e qëndrimit shoqëror.

40.1.8 Për vitin 2016 - subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, është vlerësuar “Shumë Mirë” për aftësitë personale e qëndrimit shoqëror.

## 40.2 Integriteti

40.2.1 Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Alfred Progonati, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

## 40.3 Paanësia

40.3.1 Nga 3 (tre) dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 (pesë) dosjet/praktikat e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, prokurorit Alfred Progonati. Në asnjë prej dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Në dokumentet ligjore dhe në aktet e dosjeve të vëzhguara

nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

40.3.2 Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit prokurori Alfred Progonati të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

#### **41. Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional**

##### 41.1 Aftësitë e komunikimit

40.1.1 Në dosjet e vëzhguara, si dhe në dokumentet e dorëzuara prej subjektit të rivlerësimit, prokurori Alfred Progonat, ka shprehur aftësi personale në arsyetimin dhe logjikën e akteve. Ka qenë i qartë, i kuptueshëm dhe me rrjedhshmëri mendimi.

40.1.2 Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. prokurorit Alfred Progonati, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se:

40.1.3 Për vitin 2014 – subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, është vlerësuar “Shumë Mirë” për aftësitë personale dhe të qëndrimit shoqëror.

40.1.4 Për vitin 2015 - subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, është vlerësuar “Shumë Mirë” për aftësitë personale dhe të qëndrimit shoqëror.

40.1.5 Për vitin 2016 subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, është vlerësuar “Shumë Mirë” për aftësitë personale dhe të qëndrimit shoqëror.

##### 40.2 Aftësia për të bashkëpunuar

40.2.1 Në dokumentet ligjore dhe në dosjet e urdhrat e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit, prokurori Alfred Progonati ka aftësi për të bashkëpunuar me kolegët ndërkohë që nuk ka të dhëna në lidhje me bashkëpunimin me administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

40.2.2. Nga vlerësimet e punës së subjektit i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se:

40.2.3 Për vitin 2014 - subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, është vlerësuar “Shumë Mirë” për aftësitë personale dhe të qëndrimit shoqëror.

40.2.4 Për vitin 2015 - subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, është vlerësuar “Shumë Mirë” për aftësitë personale dhe të qëndrimit shoqëror.

40.2.5 Për vitin 2016 - subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Progonati, është vlerësuar “Shumë Mirë” për aftësitë personale dhe të qëndrimit shoqëror.

#### 40.3 Gatishmëria për t’u angazhuar

40.3.1 Subjekti i rivlerësimit, prokurori Alfred Progonati, referuar deklarimeve të tij në formularin e vetëvlerësimit profesional si dhe dokumenteve shoqëruese, rezulton se është angazhuar në aktivitete që i kanë ofruar njohuri në lidhje me të drejtën e lirisë personale, policia, prokuroria dhe garancitë e të akuzuarit gjatë hetimit penal, për parandalimin e krimit dhe administrimin e drejtësisë, për përforcimin e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, për mbrojtjen e dëshmitarëve, marrëdhëniet me median, forcimi i aspektit operacional dhe logjistikë të Drejtorisë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, Mbrojtja e Dëshmitarëve në Luftën ndaj Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, për masat procedurale për mbrojtjen e dëshmitarëve, etj.

#### 40.4 Rekomandimi i relatorit për vlerësimin e aftësive profesionale

40.4.1 Për sa më sipër, relatorja e çështjes, mbështetur në raportin e Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, ka qenë eficient dhe efektiv në masë të pranueshme. Nuk është gjetur asnjë indice apo element që cenon figurën e prokurorit, për z. Alfred Progonati, sipas parashikimeve në nenin 44/a të ligjit nr. 84/2016 dhe propozoi për subjektin e rivlerësimit: “I aftë”.

### **D. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe nenit 59 pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit e rivlerësimit, z. Alfred Progonati, prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 20.12.2018.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Genta TAFA (BUNGO)**

**Kryesuese**

**Xhensila PINE**

**Anëtare**

**Pamela QIRKO**

**Relatore**

*Fiorela Mandro*  
*Sekretare gjyqësore*